faqe që në syt të lëvdojnë po me zemër të tradhtojnë, ruaju nga ata që të kesh fat dhe jetë të gjatë.

20) B.B.D. = O çilsi i fatit! Këtë qëllim që ke në zemër mos e bëj se në këto dit nevoja nuk të mbarohet; po të bëjsh durim shpëton nga gjith hidhrimet si kundër shpëtoj edhe lajmëtari Hazreti Ejjubi nga provimet. Ka shum njerës që nuk t'a duan fatin po fati ësht me ty me sa je në rrugë të drejtë.

21) B.A.A. = O bilbil i fatit! Ti do të gëzohesh mbrënda kënaqësisë së Zotit dhe do të shpëtojsh nga sherri i robit. Prej ngushtësirës ke me dalë në dritë sikundër lajmëtari Hazreti Jonuzi që dolli nga barku i peshkut edhe ke me fitue dëshirat.

22) B.Xh.Xh. = O çilsi i fatit! Këtë qëllim mbaje me durim. Je në një hidhrim si kur ke rënë në detë po puno punra hajir që të gjejsh fatin e mirë sa miqtë të gëzohen dhe armiqtë të dërmohen. Fjalës së tjatrit mos i verë vesh që të shpëtojsh e të rrokish dëshirën.

23) B.Xh.D. = O bilbil i fatit! I Madhi ZOT ty do të përgëzojë me shum të mira që do vinë nga nuk pandehet dhe dëshira e jote do të mbarohet (inshaell-llahu teala).

24) B.Xh.B. = O bilbil i fatit! Ky fat që të takon ësht fat i H. Pejgamberit që dolli prej errësirës në dritë ashtu të ngjet edhe ty po duket se ke edhe një udhëtim të mbarë që të plotson dëshirën. Ti vehten t'ënde po e mban gjithnjë në dyshim, porse ketë dyshim largoje edhe çdo gjë pazarose mirë që të ja shohish hajirin e të fitojsh dëshirën.

25) B.D.B. = O bilbil i fatit! T'a dish se porta e Rahmetit t'u hap e do të fitojsh muradin. Pra bëj tobe tue punue hajir që të jesh fatmirë përherë. Mikun dhe armikun e njih mirë. Prano këshillë që të trashëgojsh si Prilli. Kalove një hidhrim po ke edhe gëzim. Pra qëllimin e mbaj me durim.

26) B.A.B. = O çilsi i fatit! Para ke pak mundim e turbullime po pastaj puna të kthehet për hajir; myzhde të qoftë se në kohën e pritme s'ke mundim po vetëm gëzim (inshaell-llahu teala).

27) B.A.Xh. = O çilsi i fatit! Ky fat ësht si fat i lajmëtar Hazreti Jonusit që para hoqi mundim pastaj gjeti shpëtim. Ashtu edhe puna jote para ka dallgë të madhe pastaj fati të qafon dhe dëshirat t'i plotson me dy nimete të brëndshme e të jashtme.

28) B.A.D. = O çilsi i fatit! Ka shum njerës që të mirën nuk t'a duanë po fati ësht me ty se i Madhi ZOT armikët t'ënd i poshtroj dhe ty të mëshiroj dhe do të përgëzojë me shum pasuni. Ke armiq me dy faqe që tregohen miq po s'kan ç'të